



Termet e referencës Grupi Punues për Çështje Teknike

QËLLIMI

Ky dokument përmbledhë përshkrimin e punës për Grupin Punues për Çështje Teknike për përpilimin e Strategjisë për Digjitalizim të Republikës së Kosovës (tash e tutje Strategjia) me qëllim të arritjes së objektivit Nr. 1 të KPM-së për vitin 2010.

Grupi Punues për Çështje Teknike është themeluar me vendimin Nr. 0901/0045/KKPM/dd të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media për të hartuar pjesën teknike të strategjisë.

FUNKSIONI

Funksioni i Grupi Punues për Çështje Teknike është të hartojë pjesën teknike të Strategjisë, të merr pjesë në takime me publikun për diskutimin e draftit, të bashkëpunojë me katër grupet tjera punuese për strategjinë e digjitalizimit dhe të jap kontributin e tyre në finalizimin e Strategjisë.

Grupi punues për Çështje Teknike do të punojë në: **a)** detajizimin e planit alternativ përmes koordinimit të brendshëm për të siguruar pranueshmëri nga të gjitha palët me interes; **b)** do të hartojë plan veprimin për punën e koordinimit të frekuencave me shtetet fqinjë dhe **c)** do të angazhohet në krijimin e të gjitha dokumentacioneve relevante të nevojshme për t'ju qasur Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikimeve (ITU-së) me kërkesë për shqyrtim të planit të modifikuar frekuencor për Kosovën.

Funksioni i Grupit punues skadon me finalizimin e Strategjisë.

PËRBËRJA E GRUPIT PUNUES:

Grupi Punues për Çështje Teknike përbëhet nga këta anëtarë:

Emri	Pozita
1. Naile Selimaj -Krasniqi	Shefe Ekzekutive, KPM
2. Sadije Nikshiq	Anëtare e Këshillit të KPM
3. Besim Rexhepi	KPM

4. Besim Govori	KPM
5. Gani Bujupi	KPM
6. Liridon Cahani	RTK
7. Myzafere Limani	Fakulteti Elektroteknik
8. Agim Kukaj	MTPT
9. Fatmir Berisha	KTTN
10. Visar Hoti	AMPEK/Mediat Lokale
11. Edvard Kolnrekaj	AMPEK/Mediat Lokale
12. Besnik Berisha	ART
13. Synavere Rysha	Kuvendi i Kosovës
14. Besar Spahija	KTV
15. Xhevdet Gashi	TV 21
16. Emil Blakaj	Ekspert për çështje digjitalizimi
17. Elton Poga	Ekspert për çështje digjitalizimi
18. Artan Bajrami	Kujtesa Net Sh.P.K.
19. Veroljub Miletiç	Mediat Lokale/TV Most

OBLIGIMET E ANËTARËVE TË GRUPIT

Të gjithë anëtarët e grupit duhet:

- T'i respektojnë termat e referencës së Grupit;
- Të pranojnë një kopje dhe të lexojnë ligjin për KPM-në dhe materialet tjera të prodhuara nga aktivitetet e KPM-së për digjitalizim dhe materialet tjera relevante që kanë të bëjnë me punën e përgjithshme të KPM-së.
- Të deklarojnë konflikt (eventual) të interesit në fillim të takimit.
- Të kenë pjesëmarrje aktive në të gjitha takimet, duke iu përgjigjur ftesës së dërguar nga Sekretariati. Në rast se për ndonjë arsye personale, anëtari nuk do të ketë mundësi të marrë pjesë në takim, informata me shkrim duhet t'i dërgohet sekretariatit dhe ai/ajo nuk ka të drejtë të dërgojë zëvendësim
- Të japin kontribut aktiv në grup punues duke shprehur mendime se çka duhet të përmbajë pjesa teknike e Strategjisë dhe cilat çështje duhet adresuar ashtu që të definohet një vizion i qartë i zhvillimit dhe mënyrat e zbatimit të procesit të digjitalizimit
- Të japin informata për grupin punues duke ndihmuar përshtatjen e planit strategjik në mjedisin evolues të teknologjisë.
- Të ndihmojnë në përpilimin e dokumentit final.

EKSPERTIZA E BRENDSHME, PËRFAQËSUES TË INSTITUCIONEVE DHE PALËVE TJERA ME INTERES - DETYRAT SPECIFIKE

Përveç obligimeve të cekura më lartë ekspertët e vendit si dhe përfaqësuesit e organizatave/institucioneve dhe palëve tjera me interes kanë për obligim :

- Të japin ekspertizën e tyre relevante gjatë përpilimit dhe finalizimit të strategjisë.
- Të paraqesin perspektivën e institucioneve të tyre në lidhje me planin strategjik dhe procesin e digjitalizimit në përgjithësi;
- Të japin informata për grupin punës duke ndihmuar përshtatjen e planit strategjik në sferën e fushë veprimtarisë së tyre dhe interesit të përbashkët në këtë aspekt.

EKSPERTIZA E JASHTME

Grupi Punues për Çështje Teknike ka të drejtë që kohë pas kohe të kërkojë ndihmë nga ekspertë të jashtëm për çështje të caktuara për të cilat mungon ekspertiza brenda grupit punues në Kosovë. Në këtë rast, Grupi Punues do t'ia paraqesë këtë kërkesë Sekretariatit përmes Kryesuesit.

Përshkrimi i punës për angazhimin e tyre do të jetë dokument i veçantë.

KUORUMI

Kuorumi përbëhet nga 50% të anëtarëve të Grupit Punues për Çështje Teknike.

TAKIMET

Grupi Punues për Çështje Teknike do të takohet të paktën 2 herë në muaj

Agjenda e takimeve dhe dokumentet tjera që kanë të bëjnë me punën e Grupi Punues për Çështje Teknike do t'i dërgohen Grupit disa ditë para mbledhjeve që t'u jepet mundësi anëtarëve të familjarizohen me materialet.

Pas çdo mbledhjeje do të hartohet procesverbali i cili do të ratifikohet në mbledhjen e radhës. Pas ratifikimit, procesverbali nënshkruhet nga Kryesuesi i Grupit punues.